



06/813/00-493
02-03-2018

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	Ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë, z.Uran ismajli	DATE DATUM DATE	02.03.2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	<i>Imet Rrahmani – Deputet i LDK-së</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	<i>Pyetje Parlamentare</i>		

Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës së Kuvendit të Kosovës.

Çështja: : Reforma në shëndetësi parasheh edhe reformimin e formës së financimit të shëndetësisë dhe krijimin e mundësive të reja për shtimin e buxhetit dhe financim të qëndrueshëm. Zhvillimi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore përpos që është i domosdoshëm është edhe obligim ligjor. Një nga hapat e nevojshëm për hapjen rrugë të këtij procesi është edhe ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit të sigurimeve shëndetësore.

Pyetja parlamentare Z. Ministër, çka po ndodh me Ligjin për sigurime shëndetësore dhe pse nuk është proceduar deri tash në Parlament?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLIC OF KOSOVO
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Kuvendi i Republikës së Kosovës

06/912/10-547

Date
Datum
Date 23.03.2018

PËR / ZA / TO	Uran Ismajli, Ministër i Shëndetësisë	DATE DATU M DATE Reference	23 mars 2018
NGA / OD	Time Kadrijaj, Deputete, Grupi Parlamentar i AAK-së		
/ FROM SUBJEKTI PREDMET T SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë ✓		

Në bazë të Rregullës 45.2 të Rregullorës së Punës së Kuvendit të Kosovës bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës

Çështja: Shpesh herë nëpër mediat tona është përfol qështja e stendave. Shumë pacient që janë trajtuar nëpër klinikat private për këtë qështje kanë paguar shuma të larta për këtë intervenim dhe ka ndodhë që kur këta pacient kanë kryer vizita qoftë brenda apo jashtë vendit ka rezultuar se nuk e kanë numrin e stendave për të cilat kanë paguar, (nëse ju është thënë që i kanë dy stenda apo tri stenda, ka rezultuar që kanë në apo dy stenda).

Sipas kësaj kjo qështje është komercializuar skajshmërisht dhe mendoj që është shumë shqetësuese.

Pyetja: Cilat janë veprimet që ka ndërmarrë Ministria e Shëndetësisë, për të saktësuar apo për të demantuar këto ngjarje?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Propozime dhe Parashitresa-Kancelaria e Presidencës / Predstavio-Table Office

No. Prot. 06/1022/90-583
Pril. No. 06-04-2018
Data 06-04-2018
Fito
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

PËR / ZA / TO	Zv.Kryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme z. Behgjet Pacolli	DATE DATUM DATE	06.04.2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	Samir Kurteshi- deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE!		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA

Nnëshkrimi i Marrëveshjes Ndërkombëtare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Italiane për punësim fitimprurës të familjarëve që bashkëjetojnë me aneëtarët e stafit diplomatik, konsullor, administrativ e teknik. nënshkruar në Romë, më 25 janar 2018 në gjuhët italiane dhe angleze, nga ministri i Jashtëm të dy vendeve, z. Behgjet Pacolli dhe Angelion Alfano, e ratifikuar me Dekretin Nr. DMN - 006 - 2018 nga Presidenti i Kosovës më 06.03.2018.

PYETJA

I nderuar z. Ministër,

Cila është arsyeja apo cilat janë arsyet që kjo marrëveshje është nënshkruar vetëm në gjuhën e njërës palë, atë italiane dhe në "një gjuhë të huaj, të pranuar bashkërisht për të dyja palët", atë angleze, por jo në gjuhën e të dy palëve, dmth. edhe në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Parashitese-Kancelaria za Predloge i Predstavka-Table Office

Nr. Prot. 06/1025/10-586
Bil. Prot. Prot. No.
Data Datum 06.04.2018
Date Date
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

PËR/ZA/TO	Ministrin e Shëndetësisë z. Uran Ismaili	DATE DATUM DATE	06.04.2018
		Reference	
NGA/OD/FROM	Albulena Haxhiu- deputete e GP Lëvizja VETËVENDOSJE!		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA

Në kontratën e punës së infermierëve të QKUK'së e nënshkruar në vitin 2012, është e cekur që gjatë ditës së premte dhe vikendeve pra e shtune dhe e diele, duhet të bëhet pagesa prej 50% në orë për punë, sipas Ligjit të Punës, saktësisht paga shtesë.

PYETJA


A jeni në dijeni që kjo pagesë realizohet vetëm për mjekët dhe jo për infermierët?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKES SË KOSOVES
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Propozime dhe Parashtrasa-Kancelarija za Predloge i Predstavka-Table Office

Pr. Prot. No: 06/1026/10-587
Data Datum Date: 06.04.2018
PRISTINE - PRISTINA - PRISTINA

PËR/ZA/TO	<i>Ministrin e Infrastrukturës</i> z. Pal Lekaj	DATE DATUM DATE	06.04.2018
		Reference	
NGA/OD/FROM	Albulena Haxhiu- deputete e GP Lëvizja VETËVENDOSIE! 		
SUBJEKTI PREMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA

Nexhat Krasniqi deri në vitin 2008 ka qenë i punësuar në cilësinë e drejtorit të Prokurimit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Gjatë punës së tij në këtë Ministri, ka dhënë tendra kompanive të ndryshme në formë të kundërligjshme me çka ka dëmtuar me miliona euro buxhetin e Republikës së Kosovës. Në lidhje me këto afere korruptive, Gjykata Themelore, ka dënuar me 26 muaj burg efektiv për veprën penale *Keqpërdorim i Pozitës apo Autoritetit Zyrtar në bashkëkryrje*.

Pas apelimit në Gjykatën e Apelit, kjo Gjykatë ka marrë vendim që të pandehurit t'i shqiptohet dënimi me 1 vit e gjashtë muaj burg me kusht.

Gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore, lidhur me këtë rast, ai është emëruar si drejtor i Prokurimit në Ministrinë e Infrastrukturës. Në këtë periudhë Sekretari i Ministrisë së Infrastrukturës Xhelal Bekteshi ka suspenduar të pandehurin nga pozita në mbështetje të Ligjit për Shërbyesit Civil dhe ka ndaluar që t'i ofrohet zyreve të prokurimit publik të kësaj Ministrie.

Edhe pse i dënuar me burgim, z. Krasniqi në kundërshtim me Ligjin për Shërbyesit Civil, me 2 mars 2018 është rikthyer sërish si Drejtor i Prokurimit Publik në Ministrinë e Infarstrukturës

PYETJA

Pse kemi lejuar rikthimin sërish në pozitën e Drejtorit të Prokurimit të Ministrisë së Infrastrukturës, personin i cili është dënuar me vendim nga Gjykata Themelore dhe është vërtetuar nga Gjykata e Apelit , Supremes dhe Gjykata Kushtetuese?



REPUBLICA E KOSOVES KUVENDI I REPUBLIKES SE KOSOVES SKUPSTINA REPUBLIC OF KOSOVO ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO Zyra për Propozime dhe Parashitja-Anonizim dhe Përditësim të Propozimeve, Tabela 01/18	
Nr. Prot. Bl. Prot. Prot. No.	06/1053/0-597
Nr. faqeve Broj stranica No. pages	11.04.2018
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

FËR/ZA/TO	Z. Uran Ismaili Ministër i Shëndetësisë	DATE DATUM DATE	11.04.2018
		Reference	
NGA/OD/FROM	Besa Baftiu Deputete e Grupit të Deputetëve të Pavarur		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja: Çertifikatat mjekësore të obligueshme

Pyetja Parlamentare

I nderuari ministër z. Ismaili,

Ka një kohë të gjatë që çertifikatat mjekësore të obligueshme nuk po lëshohen nëpër QKMF-të. Sipas statistikave të hyrat e QKMF-ve nëpër Kosovë kanë rënë me 3-4 fish pasi që tani këto çertifikata lëshohen ekskluzivisht nëpër institucionet shëndetësore private.

Z. ministër, a do të ndërmerrni diçka në mënyrë që çertifikatat mjekësore për patent shoferë të lëshohet edhe nga institucionet publike shëndetësore?